



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 08.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "International Security Association" për aktivitetin: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

V E N D I M

-REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "International Security Association" e datës 04.03.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 01.03.2021, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

*-Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 01.03.2021 ;
-Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.*

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "International Security Association" me datë 04.03.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211. Autoriteti Kontraktues, me datë 08.03.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Pretendimi juaj se Autoriteti Kontraktues është bazuar në pretendimet e OE-ik "Rojet e Nderit" e jo e sqarimet tuaja është plotësisht i pa qëndrueshëm, pasi që të gjitha dëshmitë tuaja janë shqyrtuar dhe të njëjtat janë trajtuar sipas interpretimit nga KRPP-ja si organ i autorizuar për interpretimet ligjore;

-Poashtu pretendimet tuaja se Mehmet Bazajt i është ndryshuar kualifikimi i veprës penale në kundërvajtje nuk është dokumentuar askund në sqarimet tuaja, por e vetmja gjë që është konstatuar është ndryshimi i masës ndëshkuese ndaj të njëjtit nga dënimi me burgim në dënimin me pune detyruese për komunitetin dhe kjo nuk mund të trajtohet ndryshe pos ashtu si që është shkruar, që d.m.th. se në të gjitha rastet dhe Vendimet i njëjti është trajtuar si fajtor ;

-Poashtu dëshmia se ju keni larguar punetoret nga puna pas kryerjes se veprës penale nuk i ben ata e as ju si OE-ik te pafajshëm;

-Pretendimet lidhur me kinse padrejtësitë ndaj jush nga Vendimet paraprake te OSHP-se poashtu nuk qëndrojnë, pasi qe Autoriteti Kontraktues ne te gjitha rastet ka respektuar rekomandimet qe kane rrjedh nga ato Vendime, si qe eshte vepruar edhe me rastin e Urdhereres nga OSHP-ja ne baze te te cilës ju jeni rekomanduar per kontrate, ndërsa arsyet per kthimin ne rivleresim e dini se nuk kane rrjedh nga Autoriteti Kontraktues, por nga ankuesi dhe nga Vendimi i OSHP-se;

-Lidhur me pretendimin tuaj se interpretimi i KRPP-se nuk eshte i drejte mund ti drejtoheni atij Organi, ne vetëm ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues eshte ligjërish i detyruar qe te respektoj do rregulle te shkruar ne cfardo forme nga i njëjti.

Nga këto sqarime eshte e qarte se Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne harmoni te plote me Nenin 65 te Ligjit per Prokurimj Publik dhe me intetrpretimin e KRPP-se gjithnjë duke u bazuar ne faktet e dorezuara me sqarimet tuaja.

Bazuar ne sqarimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet, si qe eshte shënuar edhe ne dispozitivin e këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit